



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GËNËRALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit. 23.11.1-2009-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR
TË N.Q. "TERMOKOS" PRISHTINË PËR VITIN E
PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2009**

Prishtinë, Qershor 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Objektivi i Auditimit dhe Fushëveprimi
- IV. Qasja e auditimit
- V. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- VI. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojca:

- I. Komentet e Entitetit të Audituar dhe Konkluzionet e ZAP-it

Lista e shkurtesave dhe fjalëve

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BD	Bordi i Drejtoreve
BE	Bordi Ekzekutiv i Drejtoreve
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DUD	Dokumenti Unik Doganor
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
LMFPP	Ligji “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” Nr. 03/L-048
LPP	Ligji i prokurimit Publik nr. 2003/17
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
NRB	Numri i Regjistrimit të Biznesit
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
TI	Teknologji Informative
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të Kompanisë së Ngrohtores Qëndrore Termokos-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme.

Rishikimi i raporteve financiare, transaksioneve financiare dhe procedurave të vendosura mbi kontrollin e menaxhimit financiar kanë identifikuar dobësi në shumicën e fushave kryesore, të cilat duhet t'i adresohen urgjentisht Bordit të Drejtoreshave në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i kompanisë.

Auditimi ka rezultuar me të gjeturat si në vijim:

1. Mosrespektimi i kontratës për furnizimin me mazut, sipas vlerësimeve tona, kompanisë i ka kushtuar me një humbje mjetesh prej 307,497€;
2. Mungesa e një sistemi mbi menaxhimin e pasurive fikse;
3. Mungesa e manualeve dhe procedurave të shkruara lidhur me kryerjen e shërbimeve ekonomike dhe financiare si dhe mangësitë në raportimin financiar;
4. Mungesa e ndarjes së qartë të detyrave (veçanërisht tek ndarja e funksioneve të autorizimit, procesimit dhe kontrollimit të pagesave dhe inkasimeve);
5. Nuk ka politika të qarta kontabël mbi përgatitjen e pasqyrave financiare;
6. Nuk ekziston kontrolli formal mbi përgatitjen e pasqyrave financiare nga saldot e llogarive përfundimtare të gjeneruara nga sistemi i kontabilitetit;
7. Ka mospërputhje të shumave të faturimit dhe të sistemit kontabilitetit;
8. Raportimet nga Departamentet e Kompanisë për nevojat e KE dhe BD kanë mangësi të shumta;
9. Mangësitë e evidentuara tek procedurat e prokurimit lidhur me shpenzimet të përcaktuara me LPP dhe rregulla tjera janë domethënëse;
10. Nuk ka politika të qarta mbi arsyeshmërinë e shpenzimeve të derivateve për automjete.

Shembujt e mësipërm janë tregues i qartë i problemeve të dobëta brenda Kompanisë, të cilat janë përshkruar hollësisht në kapitullin VI të këtij raportit. Konkludimi i përgjithshëm i auditimit është se menaxhimi financiar është i përcjellur nga shumë mangësi, është joadekuat dhe kërkon përmirësime substanciale.

Rekomandimi ynë kryesor është që Bordi i Drejtoreshave duhet urgjentisht të zhvillojë një program me qëllim të forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e tij ta monitoroj nga afër.

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare është kryer nga një firmë private e auditimit e angazhuar nga ana e Kompanisë.

Menaxhmentit të Termokos i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 1.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të Institucioneve Publike të Kosovës.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë auditimin e menaxhimit financiar të kompanisë publike “Termokos” në Prishtinë për vitin 2009, ngase Auditimi i Pasqyrave financiare ishte kontraktuar nga një kompani tjetër auditimi.

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të Ngrhtores Qendrore “Termokos” që të vendosë kontrolle të përshtatshme për menaxhimin financiar si dhe të ndërtoj një sistem efikas dhe efektiv të kontrolleve të brendshme.

III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka të bëjë me cilësinë e kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit financiar të “Termokos” për vitin 2009.

Fushëveprimi i auditimit është fokusuar në përgjegjësitë mbi menaxhimin financiar, lidhur me:

- Nëse të dhënat kontabël dhe raportimi i brendshëm janë të mjaftueshme;
- Nëse të dhënat kontabël, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Kontrollat e menaxhmentit mbi aplikacionet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

IV. Qasja e auditimit

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e “Termokos”, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

1. Kemi rishikuar raportet financiare të Termokos-it në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009;
2. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
3. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
4. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
5. Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Termokos.

V. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në auditimin e kaluar, opinioni për pasqyrat financiare të “Termokos” për vitin 2008 ishte *i kualifikuar*. Arsytet për këtë ishin:

- Mos harmonizimi i të dhënave në sistemin elektronik me regjistrimet burimore të faturimit të të hyrave. Për më tepër, mënyra e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave në sistem krijon dyshime në saktësinë dhe sigurinë e tyre;
- Politika e njohjes së provizioneve të borxheve të dyshimta dhe të këqija duhet të jetë e pranueshme sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- Politika e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave, siguria e qasjes së TI-së;
- Paraqitja e vlerës së pasurisë në Pasqyrat Financiare duhet të jetë në bazë të kostos historike dhe mungesa e një programi për evidencën e pasurive;

Gjatë vitit 2009, “Termokos” nuk i ka adresuar në mënyrën e duhur rekomandimet e dhëna. Nga 6 rekomandime të dhëna për vitin 2008, ne kemi testuar 5 prej tyre, prej të cilave 4 nuk janë zbatuar fare kurse 1 është zbatuar pjesërisht. Menaxhimi i pasurive nuk është testuar në këtë fazë për arsye se ende nuk janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare.

Dështimi për t’i adresuar plotësisht rekomandimet audituese ka shkaktuar ekzistimin e problemeve të njëjta sikur viteve të kaluara. Aty ku çështjet konsiderohen ende të rëndësishme, ato janë përsëritur në seksionet më poshtë. Mungesa e masave të vendosura lidhur me rekomandimet e auditimit janë një shqetësim.

VI. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

VI. 1 Procedurat e buxhetimit

Kompania përgatit buxhetet vjetore të cilat parimisht janë subjekt i aprovimit të Bordit të Drejtorëve. Mirëpo, nuk ekziston procesi formal i buxhetimit përfshirë metodologjinë e përgatitjes dhe ekzekutimit të buxheteve. Personi përgjegjës mbledh informacione që ofrohen nga departamentet e ndryshme gjatë përgatitjes së buxhetit.

Kompania nuk posedon bazë të dhënash komplete ku shpalosen informacionet periodike rreth gjenerimit të hyrave, nivelit të shpenzimeve dhe shpenzimeve kapitale.

Ne kemi vërejtur që në nivel të departamenteve nuk është kryer asnjë analizë e performancës buxhetore, e mospërputhjeve së kostove të përgatitura nga departamenti i buxhetit me qëllim të marrjes së veprimeve korrekte për periudhën e ardhshme.

Buxheti fillestar, i rishikuar dhe plani i biznesit nuk është i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, i cili funksionon nga Qershor 2009.

Konkluzion

Përgatitja dhe aprovimi i buxheteve pa analiza të duhura dhe pa harmonizimin me objektivat e Planit të biznesit vështirëson përmbushjen e aktiviteteve operative të Kompanisë. Po ashtu, mos aprovimi i buxhetit nga Bordi i Drejtorëve vendos operacionet e parashikuara para rrezikut. Por, Kompania nuk përdorë metodat/analizat e duhura për vlerësimin e shifrave të draft buxhetit që kanë të bëjnë me të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj se:

- Buxhetet janë caktuar në bazë të një vlerësimi të qëndrueshëm të shpenzimeve të mundshme gjatë vitit financiar;
- Të hyrat dhe shpenzimet duhet të profilizohen sa më shumë që është e mundur sipas muajit ashtu që të identifikohen mënyrat e shpenzimit.
- Faktorët e jashtëm dhe paqartësitë të cilat e bëjnë ndarjen buxhetore më të vështirë duhet që në mënyrë eksplicite të shpalosen;
- Duhet të ekzistojnë rishikimet e rregullta (p.sh mujore) të shpenzimeve aktuale ndaj të hyrave aktuale dhe arsytet për ndryshimet e theksuara duhet të shpjegohen; dhe
- Buxheti vjetor i Kompanisë të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve.

VI. 2 Raportet financiare

Raportet Financiare të vitit 2009 janë të pasakta meqë përmbajnë informacione të gabuara ose jo të plotë mbi faturimet e të hyrave nga shërbimet e ngrohjes, arkëtimet nga shërbimet dhe pasuritë e kompanisë.

Konkluzioni

Sipas vështrimeve tona, "Termokosi" nuk ka një sistem operacional të kontabilitetit i cili do të prodhoj raporte financiare të besueshme nga të dhënat e sistemit kontabël dhe regjistrit të pasurive.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Raportimin e plotë të të gjitha pasurive dhe të hyrat nga ngrohja duke i shpalosur, veçanërisht në Raporte financiare, në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe politikat e kompanisë
- Të kryejë harmonizimin mujor të shënimeve të saja të kontabilitetit me shënimet financiare të sistemit të faturimit, kontabilitetit material me qëllim të identifikimit dhe korigjimit të mospërputhjeve dhe eliminimit të tyre.

VI.3 Menaxhimi i shitjeve

Faturimi i të hyrave nga ngrohja qendrore bëhet në bazë të një tarife të aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Faturimi i të hyrave bëhet për sektorin e amvisërisë dhe atë të biznesit. Në tabelën vijuese mund të shihen faturimet dhe inkasimet për vitin 2009.

Tabela 1: Faturimet dhe inkasimet 2009

Në €	Sistemi i faturimit		Raportet financiare	
	Faturimi	Inkasimi	Inkasimi	Diferenca
Janar	924,506	616,529	261,986	354,543
Shkurt	942,854	460,934	367,335	93,599
Mars	896,514	811,494	690,956	120,538
Prill	413,212	750,209	589,896	160,313
Maj	-	445,022	305,831	139,191
Qershor	-	289,221	138,502	150,719
Korrik	-	320,480	147,201	173,280
Gusht	-	133,297	59,665	73,632
Shtator	-	211,353	95,193	116,160
Tetor	384,453	322,347	225,955	96,392
Nëntor	859,419	401,208	274,849	126,359
Dhjetor	892,217	802,266	844,567	(42,301)
Gjithsej:	5,313,175	5,564,360	4,001,936	1,562,425

Të hyrat nga shitjet dhe llogaritë e arkëtueshme janë regjistruar nga departamenti i kontabilitetit. Regjistrimi i bilanceve individuale të klientëve është kryer në sistemin e faturimit nga njësitë e faturimeve. Nga tabela e mësipërme vërehet se nuk ekziston proces formal i barazimit për bilancet e gjeneruara nga sistemi i kontabilitetit me sistemin e faturimit. Rrjedhim i kësaj është mosbarazimi prej **1,562,425€**.

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur se baza e të dhënave në sistemin e faturimit të Kompanisë ka informacione jo të sakta lidhur me emrat dhe adresat e konsumatorëve aktual. Veç kësaj, ne jemi informuar se nuk ekzistojnë kontrole për të siguruar se të dhënat e vendosura në sistem janë të sakta dhe complete. Nuk ekzistojnë procedura të autorizimit për futjen e të dhënave në sistem.

Konkluzioni

Mungesa e procedurave të barazimit rrit rrezikun potencial të gabimit në regjistrim të transaksioneve të shitjes dhe llogarive të arkëtueshme, Për më tepër, kjo mund të rrit rrezikun që inkasimet të ndodhin dhe të mos procesohen fare në sistemin e kontabilitetit.

Mungesa e informacioneve të sakta lidhur me adresën e konsumatorit rrit rrezikun e faturimeve jo të sakta dhe keq deklarimet e të hyrave të regjistruara në sistemin e kontabilitetit dhe atë të deklaruara në pasqyra financiare. Veç kësaj, kjo mund të ndikoj negativisht edhe në praktikën e arkëtimit, duke rezultuar në humbje për kompaninë.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Se menaxhmenti i Kompanisë ka të vendosura kontrole të forta mbi menaxhimin e të hyrave, se të gjitha të hyrat e inkasuara dorëzohen në llogarinë bankare të kompanisë;
- Të bëhen barazime mujore apo të paktën barazime tremujore në mes Departamentit të faturimit dhe atij të kontabilitetit. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe përmirësimet e duhura duhet të bëhen në sistemin përkatës;
- Përgatit dhe implementoj një plan veprimi për të mundësuar azhurnimin e informacioneve në sistemin e faturimit të konsumatorëve si dhe të vendos kontrollet përkatëse;
- Ndarjen e detyrave (personi i cili regjistron të jetë i ndryshëm nga personi i cili proceson të dhënat në sistem ose ndryshon të dhënat) si dhe të bëjë autorizimin e kontroleve.

VI. 3.1 Zbritjet e lejuara

Zbritjet e lejuara të llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2009 janë në vlerë prej **741,671€**. Ndërmarrja pasi ka konstatuar se konsumatorët që janë ankuar nuk kanë pasur ngrohje kualitative, ju ka lejuar zbritje nga faturimi. Gjatë aktiviteteve tona audituese, ne kemi vërejtur se një pjesë e madhe e lejimeve rrjedhin nga viti 1999 e tutje.

Ne kemi vërejtur se nuk ekzistojnë politika dhe procedura të shkruara për t'u përdorur si udhëzues gjatë përgatitjes së pasqyrave të lejimeve që bëjnë të mundur ndarjen e periudhave kohore se kur konsumatori s'ka pasur ngrohje dhe kur duhet lejuar nga obligimet.

Konkluzion

Gjendja e mësipërme mund të rezultojë në keq deklarimin e pasqyrave të lejimeve për shkak se tatimi në fitim dhe trajtimi i borgjeve të këqia në mënyrë jo adekuate nuk janë identifikuar në bazë të dhënave të faturimit dhe as ndikimi i tyre në llogarinë e TVSH-së.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

Që Menaxhmenti i Kompanisë të formalizoj procesin e përgatitjes së pasqyrave të lejimeve me themelimin dhe aprovimin e procedurave të shkruara për këtë proces.

VI. 4 Shpenzimet e pagave

Tabela 1: Shpenzimet e pagave të punëtorëve për 2009

	Përshkrimi	Paga Bruto	Nr. i punëtorëve	Muaj	Paga mesatare
1	Pagat e punëtorëve	1,010,865€	208	12	405 €
2	Pagat e bordit ekzekutiv	70,996€	3	12	1,972 €
3	Pagat e bordit të drejtorëve	21,936€	4	7	783 €
	Gjithsej:	1,103,796€	215		

Nga tabela më lartë shihet se shpenzimet e stafit në fund të vitit 2009 ishin **1,103,796€** apo rreth **53 %** më të larta se një vit më parë (**721,136€**).

Zyra e rregullatorit për energji, monitoruese e ngrohjes sipas raportit rregullativ të 19 nëntorit 2008 për përcaktimin e të ardhurave të lejuara të periudhës 15 tetor 2008 deri 14 tetor 2009 kishte lejuar shpenzime të periudhës prej **755,300€** dhe gjithsej **170** të punësuar.

Konkluzion

Rritja e numrit të punësuarve përtej masës së lejuar mund të ndikoj në keqësimin gjendjes financiare të kompanisë.

Rekomandimi 5**Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:**

Që gjatë përgatitjes së buxhetit të merret parasysh raporti rregullativ i ZRRE për përcaktimin e te ardhurave të lejuara si dhe rritja e numrit të punëtorëve dhe ngritja e pagave të bëhet me aprovimin e vet Bordit Drejtues.

VI. 5 Shpenzimet e lëndës së parë - mazutit

Më poshtë prezantojmë gjendjen e shpenzimeve të mazutit për vitin 2008 dhe 2009.

Tabela 2: Shpenzimet e mazutit

	Shpenzimet e Mazutit në ton			Pasqyra e objekteve të shkyçura nga ngrohja qendrore 2009
	2009	2008	Diferenca	Sipërfaqja
Janar	3,084	2,249	835	
Shkurt	2,494	1,637	858	
Mars	2,169	859	1,310	
Prill	536	46	490	
Tetor	751	25	726	51528 m2
Nëntor	1,675	1,534	141	56964 m2
Dhjetor	2,291	2,301	(10)	70808 m2
Totali	13,000	8,651	4,349	

Nga tabela shihet se shpenzimet e mazutit gjatë vitit 2009 arrin në 13,000, më të larta se 50% ose 4,349 tonë sesa në vitin 2008.

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur se gjatë tre muajve të fundit të vitit 2009, nga shërbimet e ngrohjes kanë qenë të shkyçura mesatarisht rreth 60,000m2 kurse janë shpenzuar 4,349 tonë lëndë djegëse më tepër sesa në vitin 2008. Duket se ka mungesë të kontrolleve të duhura mbi shpenzimin e sasive të mazutit. Matjet e sasive të bartura nga deponia rezervë deri në kaldajën kryesore bëhen në mënyrë vizuale dhe me mjete mekanike (shufra të matjes) dhe jo me instrumente të sakta mbi sasinë e shpenzuara.

Konkluzion

Sipas gjendjes aktuale, Menaxhmenti i Kompanisë nuk ka kurrfarë kontrolle mbi sasinë e derivateve të shpenzuara. Ndryshimi kaq i madh në shpenzimin e sasive është mjaft indikativ dhe si i tillë tërheqë vërejtjen për humbje të mëdha të biznesit.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Se së bashku me menaxhmentin Kompanisë të formoj një grup punues për të analizuar rezultatet dhe mangësitë me qëllim të propozimit të masave të duhura;
- Menaxhmenti i Kompanisë të ndërmerr masa të menjëhershme që të forcoj kontrollet mbi shpenzimet e derivateve; të përcaktoj norma dhe politika mbi shpenzimet e mundshme, të vendos procedurat e duhura të kontrollit, të bëj ekspertizat e duhura, të raportoj në baza mujore mbi shpenzimet, të nxirren konkludimet mbi ndryshimet mujore të këtyre shpenzimeve si dhe të njoftohet Bordi i Drejtorëve.

VI. 6 Subvencionet

Gjatë vitit 2009, "Termokos" është subvencionuar nga BKK me **1,592,999 €** për blerjen e mazutit, dhe **205,000€** për investime kapitale.

Gjate testimi të subvencioneve kemi vërejtur se mjetet nga BKK janë transferuar në llogarinë e rregullt bankare të Termokos, e jo në një llogari të veçantë siç është paraparë me marrëveshje.

Nuk na është ofruar dëshmi e besueshme se ka ekzistuar projekt i detajuar për kategorinë e shpenzimeve kapitale, siç është paraparë me nenin 6 të marrëveshjes me MEF-in.

Konkluzion

Mos respektimi i marrëveshjes nga ana e Termokos-it rrit rrezikun se mjetet e destinuar për projektet e sipër përmendura, të financuara nga BKK, mund të jenë shfrytëzuar për qëllime tjera.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

Marrëveshja e datës 24.02.2009 në mes të MEF dhe Termokos mbi shfrytëzimin e subvencioneve qeveritare është zbatuar në tërësi. Në rast të parregullsive, të merren masat për llogaridhënie deri në kthimin e subvencioneve.

VI. 7 Kompensimi i Drejtorëve

Bordi i drejtorëve është emëruar me 28.05.2009 kurse pagesa e honorarëve është bërë nga 01.06.2009.

Sipas ligjit Nr. 03/L-087 për NP neni 20.2, honorari themelor për drejtorët e NP Lokale përcaktohet me një vendim të Komisionit përkatës Komunal të Aksionarëve.

Sipas nenit 20.4 te ligjit për NP thuhet se Komisioni i Auditimit do te përgatis dhe zbuloj në mënyrë publike një deklaratë për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e NP-së.

Gjatë rishikimit te dokumentacioneve nuk kemi gjetur se ka një deklaratë për politikën e kompensimit të BD për stimulimin e efektshmerisë dhe performancës. Kemi vërejtur se Kryesuesi dhe Drejtorët e BD të Termokos-it marrin edhe një shtesë mujore, kurse në nenin 20.6 Ligjit për NP, thuhet se Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP.

Me një vendim te posaçëm të BD, të gjithë punëtorët e kompanisë dhe secili anëtar i Bordit kanë marr një shtesë prej 200€ gjatë muajit dhjetor 2009.

VI. 8 Kompensimi i Drejtorëve ekzekutiv te kompanisë

Gjate testimit të pagave tek tre anëtarë të Bordit ekzekutiv, kemi vërejtur se i u janë paguar bonuse për vitin 2009, përtej pagës së rregullt, motivuar për performancë të mirë në punë në bazë të vendimit të BD.

Ne nuk kemi gjetur një bazë të përshtatshme që dokumenton një vendim të tillë.

Konkluzion

Vendimi eventual mbi bonuset mund të merret pas analizave gjithëpërfshirëse të performancës së Kompanisë dhe ndikimeve individuale mbi këtë. Kur rezultatet nuk janë shumë të mira, kjo jep sinjal të keq tek i gjithë stafi dhe kjo ka të bëjë edhe me trajtimin e diskutueshëm të mirëbesimit zyrtar.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Se të gjitha kompensimet dhe shpërblimet brenda kompanisë të jenë në pajtim me politikat e brendshme, Vendimet e Bordit dhe rregullat ligjore. Nëse politikat e tilla nuk ekzistojnë, duhet ndër marr masa që ato të hartohen sa më shpejtë;
- Pagesat pa një bazë të qartë ligjore, duhet të ndërpriten.

VI. 9 Prokurimi


VI. 9.1 Furnizimi me mazut dhe derivate të naftës për ngrohje

Lidhur me furnizimet e kompanisë me derivate dhe mazut, kemi analizuar procesin e kontraktimit, çmimet sipas kontratave dhe çmimet sipas berzës.

Për të dëshmuar ndikimin e çmimit sipas lëvizjes në berzë, kemi bërë krahasimin e çmimit të mazutit të ofruar nga grupi OE që furnizon “Termokosin” dhe operatorët ekonomik tjerë që importojnë mazut në Kosovë.

Tabela 3 Furnizimi me mazut

MUAJI	Sasia e importuar e mazutit (ton)	OE importues i mazuti për Temokosin(A) Çmimi mestar/ton	OE te tjerë që importojnë mazut(B) Çmimi mesatar/ton	Diferenca/ton	Shuma
Janar	2,865	211	201	10	28,718
Shkurt	1,974	221	226	(5)	(9,814)
Mars	3,165	227	223	4	13,220
Tetor	1,021	341	310	31	31,650
Nëntor	1,535	371	322	49	75,226
Dhjetor	2,591	367	302	65	168,408
GJITHESEJ:	13,151				307,407



Gjetjet e auditimit lidhur me këtë furnizime ishin:

- Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën 3, të marra nga DUD-i, shihet se grupi i OE që kanë furnizuar me mazut Termokos-in kanë çmimin për ton më të lart se sa OE të tjerë që kanë importuar mazut në Kosovë. Mendojmë se nga ky mosrespektim i kontratës Termokosit i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë prej 307,497€
- Përfaqësuesi i grupit nuk ka pasur licencën e lëshuar nga MTI-ja për furnizim me mazut dhe derivate të naftës, siç është kërkuar me dosje të tenderit;
- Gjatë furnizimit me mazut nuk është respektuar llogaritja e çmimit në bazë të çmimit mesatar sipas lëvizjeve të Pllat's Mediteran, siç parashihet me kontratë.
- OE ka faturuar duke u bazuar në çmimin e importit të pasqyruar në DUD dhe jo sipas çmimit të berzës siç parashihet me kontratë.
- Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike pranë MEF me një shkresë të datës 18.02.2009 ka dhënë mendimin e vet se Termokos mund të llogarit çmimin e mazutit në bazë të DUD-it. Kjo është në kundërshtim me kushtet e kontratës.

Konkluzion

“Termokos”-i i ka dhënë kontratën grupit të OE që nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara me dosjen e tenderit (kërkesat për përshtatshmëri profesionale, neni 62 të LPP).

“Termokos” ka pranuar çmimet në bazë të DUD-it, e jo në bazë të çmimit mesatar sipas lëvizjeve të Pllat’s Mediteran. Kësisoj nuk ka respektuar kontratën nr. 1428 të datës 14.10.2008.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Një grup i caktuar nga Bordi i Drejtorëve të bëjë analiza të hollësishme se cilat ishin arsyet për ndodhjen e këtyre transaksioneve, rregullsinë, ligjshmërinë e kontratës si dhe të propozoj masa të caktuara lidhur me këto kontrata;
- Të siguroj se të gjitha kontratat do të konsiderojnë kushtet aktuale të cilat i përcakton tregu.

VI. 9.2 Furnizim me gypa te paraizoluar dhe valvula

Në bazë të kontratës afati i liferimit të materialit ka qenë 14 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës kurse materiali në vlerë të pjesërishtme prej 190,414€ është liferuar me një vonesë prej 16 ditë kalendarike. Liferimi i mbetur i materialit në vlerë prej 15,345€ është bërë me një vonesë prej 24 ditë kalendarike.

Konkluzion

Termokos, përkundër dispozitave nga kontrata, nuk ka llogaritur ndëshkimet prej 15% për ditët e vonuara në liferimin e materialit.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj:

Se menaxhmenti i Termokos të forcoj kontrollin mbi zbatimin e kontratave si dhe të aplikoj gjërat ndëshkuese që zbatohen për vonesat në liferimin e mallrave dhe shërbimeve.

VI. 9.3 Furnizim me derivate të naftës për automjete

Ne kemi vërejtur mangësitë vijuese lidhur me furnizimin me derivate për automjete:

- Gjate ekzaminimit të dosjes së tenderit kemi vërejtur se një anëtar ka marr pjesë edhe në komisionin e hapjes edhe në atë të vlerësimit të tenderit;
- Operatori ekonomik që është shpërblyer me këtë kontratë nuk ka dëshmi se posedon licencë nga MTI –ja për shitjen e derivateve të naftës;

- Autoriteti kontraktues nuk e ka shpërblyar me kontratë operatorin ekonomik me çmim(premi) më të ulët(0.020 €/ lit);
- Nuk kemi gjetur dëshmi se si është kalkuluar çmimi i faturuar nga OE.

Konkluzion

Mos respektimi i kriterëve të dosjes së tenderit, dhënia e kontratës OE me çmim më të lartë dhe mos kontrollimi i faturimit të çmimit i shkakton dëm të drejtpërdrejtë buxhetit të Kompanisë.

Rekomandimi 11

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të vendos kontrolle të shtuara mbi proceset e prokurimit si:

- Një proces i duhur i kontraktimit duhet zbatuar sipas legjislacionit/udhëzimit administrativ. Duhet të ekzistoj një ndarje e qartë funksionesh.
- Vlerësimi i ofertave duhet të kryhet sipas kriterit të zgjedhur;
- Kontrata duhet të hartohet në pajtim me kriteret;
- Performanca sipas kontratës duhet të verifikohet nëse është kënaqshme ose jo; dhe
- Pagesat sipas kontratës duhet të jenë të autorizuara dhe sipas çmimeve të kontraktuara.

VI. 9.4 Depërtimi i Gypave nën asfalt

Gjatë auditimit të lëndës, “Ndërtimi i Pusetave” kemi vërejtur këto parregullsi:

- Është i formuar i njëjti komisioni për hapje dhe vlerësim;
- Pagesat janë bërë në vlerë prej 53,194€, ndërsa kontrata ka qenë në vlerë prej 43,000€, ku shihet se është paguar më tepër me një diferencë prej 10,194€.

Konkluzioni

Pagesa në vlerë prej 10,194€ është tejkuluar nga zotimi i mjeteve, është shkelje e nenit 2.1 të kontratës Nuk është respektuar neni 2.1 i kontratës në mes të autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik, që parasheh se çmimi total i kontratës duhet të jetë deri në shumën e mjeteve të zotuar.

VI. 9.5 Shpenzimet e materialit të zyrës dhe mirëmbajtja e pajisjeve të ngrohjes

Është vërejtur se “Termokos” është furnizuar me material të zyrës dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të ngrohjes pa udhëhequr asnjë procedurë të prokurimit, që d.m.th. ka kryer furnizime një burimore. Në një rast furnizimi ka qenë në vlerën prej 18,222€ dhe tjetri prej 10,852€.

Konkluzioni

Furnizimi përmes procedurave njëburimore cenon një nga parimet kryesore të prokurimit publik – transparencën, dhe kjo rrit rrezikun për keqpërdorime të buxhetit të Kompanisë.

Rekomandimi 12

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj:

Se kontrollet e duhura janë vendosur për të siguruar parimet themelore të prokurimit.

VI. 10 Menaxhimit të pasurisë

Kompania nuk posedon ndonjë manual apo procedura të shkruara mbi menaxhimin e pasurive. Të dhënat e pasurive fikse mbahen në faqe Excel-i dhe nuk ekziston ndonjë softuer i veçantë mbi administrimin e pasurive. Po ashtu, nuk ka zyrtar që evidenton pasurinë e kompanisë.

Gjatë analizës së gjendjes mbi automjetet e Termokosit kemi kërkuar dëshmi të shkruara dhe të besueshme se automjetet e regjistruara ekzistojnë dhe janë në përdorim, posaçërisht për PEZHO 407 (566 KS 971). Në raportet e shpenzimeve të derivateve, për këtë veturë nuk

kemi vërejtur se ka shpenzuar derivate gjatë vitit 2009. Ndërsa dëshmi janë ofruar vetëm për dy automjete (Xhip Nissan dhe Clio) kurse për automjete tjera jo. Dokumentacionet e ofruara nga zyrtaret e kompanisë ishin jo të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e automjeteve në përdorim.

Konkluzion

Mungesat e evidentuara më lartë janë indikacion që menaxhmenti të mos ketë kontrolle të mjaftueshme mbi pasuritë dhe kështu pasuritë mund t'i ekspozohen rrezikut të humbjeve dhe keqpërdorimit. Për më tepër ekzistenca e veturës PEZHO nuk është konfirmuar.

Rekomandimi 13

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të vendos kontrolle të duhura mbi menaxhimin e pasurive. Ndër masat e para që duhet të ndërmerren do të ishte aprovimi i një manuali i cili do të rregullonte kërkesat si në vijim:

- Caktimi i një zyrtari për menaxhimin e pasurive;
- Regjistrimin e pasurisë së kompanisë dhe krahasimin me regjistrin e pasurive të evidentuara në bazën e të dhënave;
- Mbajtja, ruajtja dhe sigurimi i pasurive;
- Heqja nga përdorimi i pasurive të pa përdorshme;
- Numërimet fizike;
- Llogarimbajtja e pasurive, përfshirë njohjen fillestare, masat pasuese, zhvlerësimin, dëmtimin dhe mospranimin, nivelet e autorizimit për përvetësime dhe transfere.
- Barazimet dhe bërja e kontrolleve periodike.

VI.11 Sistemi i Kontrollit të Brendshëm

Një prej aspekteve të pazgjidhura nga Kompania që është vërejtur gjatë punës tonë janë përpjekjet e pamjaftueshme për adresim të rreziqeve në nivelin strategjik. Ne kemi vërejtur lëvizjen e mbi 80 personave brenda organizatës. Nga numri prej 215, vetëm 134 punëtor kanë punuar rregullisht 12 muaj të plotë, kurse 80 të tjerë kanë punuar kohë pas kohe.

Siç është përmendur në pikat e ndryshme në këtë raport, dobësitë më të theksuara të kontrollit të brendshëm janë vërejtur tek:

- Mos ndarja e duhur e detyrave me qëllim të forcimit sa më të madh të kontrolleve;
- Mungesa e Rregulloreve të brendshme dhe procedurave të shkruara;
- Mos funksionalizimi i organeve të duhura për qeverisje të përbashkët, siç janë funksionalizimi i komisionit të auditimit, Bordit drejtorëve, dhe komisionet tjera profesionale;
- Mungesa e procesit të duhur të buxhetimit dhe parashikimit;
- Lëvizjet e shpeshta të menaxhmentit në nivelet e larta të organizatës si dhe të stafit në përgjithësi.

Konkluzion

Termokos nuk ka sisteme të përshtatshme të kontrollit të brendshëm. Organizata do të jetë aq efektive dhe e suksesshme për aq sa i ka të forta kontrollet.

Rekomandimi 14

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Se menaxhmenti ka një strukturë të qartë të ndarjes së detyrave (organizative);
- Të nxjerrë rregullore të brendshme dhe vendos procedura të përshtatshme për të gjitha fushat e biznesit;
- Të forcohen kontrollet e Bordit Drejtues mbi raportimet financiare, buxhetin, politikat mbi llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme;
- Të hulumtoj arsyet mbi lëvizjet e shpeshta të menaxhmentit si dhe të stafit, dhe të ndërmer masat e duhura .

VI. 12 Auditimi i Brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm akoma nuk është themeluar ende si një departament i ndarë, edhe pse një zyrtar i auditimit ishte dominuar, por ne nuk kemi gjetur çfarë ka bërë ai. Asnjë raport i auditimit nuk ishte përgatitur. Ne nuk ishim në gjendje të vlerësojmë performancën e tij. Gjithashtu, ishte themeluar edhe Komisioni i Auditimit, por ne nuk kemi mund të shohim çfarë aktivitete ka mbuluar.

Konkluzion

Menaxhmenti është përgjegjës për dizajnimin e sistemit të kontroleve të brendshme (strukturat, aktivitetet, proceset dhe sistemet që ndihmojnë menaxhmentin në zvogëlimin e rreziqeve deri në një shkallë të pranueshme).

Rekomandimi 15

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj:

Marrjen e masave të menjëhershme për themelimin e funksionit të Auditimit të brendshëm si dhe funksionalizimin e Komisionit të Auditimit brenda Kompanisë.

Shtojca 1

Menaxhmentit të Termokos i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Komentet e Termokosit dhe konkluzionet e ZAP

NR	Referenca	Komentet e Termokosit	Vlerësimet e ZAP
1.	VI.1 Procedurat e Buxhetimit	<p>Pretendimet në draft-raport janë të paqëndrueshme, për këto arsye :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompania përgatit buxhetet vjetore në bazë të të dhënave nga departamentet dhe duke u bazuar në analizën se si janë planifikuar; • Kompania, posedon bazë të dhënash komplete ku shpalosen informacionet lidhur me të hyrat në bazë të sipërfaqes katrore dhe objektivat e realizimit në përqindje të inkasimit. <p>U kemi ofruar dokumentacion të mjaftueshëm që këto t'i konstatojnë në mënyrë të drejtë dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> * plani i buxhetit 2009 * plani i biznesit 2009 * rishikimi i buxhetit 2009 * krahasimi i planifikimeve me shpenzimet reale deri 11/2009 * krahasimi i planifikimeve më reale në total deri 12/2009, me sugjerim se ende nuk është mbyllur viti. <p>Fakte shtesë të dërguara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - metodologjinë e planifikimit të të hyrave - dinamikën kryesore të buxhetit 2009 - një formë të raportit mujor, krahasim mes reales dhe të planifikuarës <p>Mosaprovimi i planit të buxhetit nga BD për vitin 2009 nuk është me fajin e kompanisë as të BD ngase BD nuk ka ekzistuar</p>	<p>Gjatë përpilimit dhe zbatimit të buxhetit nga menaxhmenti nuk iu ka kushtuar vëmendje rreziqeve strategjike, operacionale dhe rrezikut financiar e posaçërisht atij të likuiditetit.</p> <p>Të planifikosh të punosh me humbje dhe pjesërisht të financohesh nga mjetet e Buxhetit e Konsoliduar të Kosovës e të rritësh buxhetin e shpenzimeve të kategorisë së pagave për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 mbi 80%, është tregues i qartë i planifikimit të dobët.</p> <p>Mungesa e analizës së shpenzimeve të përgjithshme operative dhe të mirëmbajtjes në planin e biznesit që janë orientues ekskluziv në drejtim të realizimit të objektiveve strategjike dhe zhvillimin e një biznesi të qëndrueshëm, po ashtu forcon konkludimin më lart.</p> <p>Mungon plani i zhvillimit të personelit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura e vendeve të punës dhe pagesa bazë; • Totali i punëtorëve sipas kategorive; • Vlera e pagës bazë për një punëtor (sipas kategorive) gjatë vitit 2009. <p>Vlen të theksohet vetëm analiza e kategorisë së pagave, ku për 176 të punësuar, shpenzimet për</p>

		<p>fare për shkak të shkuarjes së AKM-së dhe këtë ua kemi sqaruar edhe më parë.</p> <p>BD ka funksionuar prej 05/2009 andaj shtrohet pyetja si ka mund BD ta aprovoj planin e buxhetit në janar kur nuk ka ekzistuar fare.</p>	<p>paga për vitin 2008 ishin 721,135€, kurse gjatë vitit 2009 pagat për 215 të punësuar ishin 1,103,796€.</p> <p>Ky tregues është i mjaftueshëm që jep të kuptohet se si është planifikuar, analizuar dhe realizuar buxheti i kompanisë, që vetëm në kategorinë e pagave ka një rritje prej 52% në krahasim me vitin 2008.</p> <p>Buxheti i rishikuar për vitin 2009 ka pas mundësi t'i prezantohet BD për shqyrtim dhe aprovim, pasi që ky bord ka filluar të funksionoj nga Maj 2009. Konkluzionet e auditimit mbeten të pandryshuara në raport dhe në presim që rekomandimet të zbatohen.</p>
2	VI.3. Menaxhimi i Shitjeve (Tabela 1)	<p>Faturimet dhe Inkasimet. Të dhënat tona rezultojnë ndryshe nga përshkrimi i shumave të cekura në tabelën e përmendur dhe të njëjtin përshkrim të diferencës e kundërshtojmë në tërësi, ngase rezultatet dhe të dhënat në Departamentin e Furnizimit dhe të Financave janë me sa vijon:</p> <p>- Vlera totale e Faturimit të realizuar gjatë periudhës 01.01.2009 deri 01.12.2009 është 5,313,177€;</p> <p>Vlera totale e Inkasimit të realizuar për të njëjtën periudhë është 4,001,937€;</p> <p>Vlera totale e Keqpërdorimeve (Kërkesat e konsumatorëve për shkarkimin e faturave të paguara të cilat nuk kanë qenë të shkarkuara më parë) të shkarkuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2009 është 664,905 €;</p> <p>Vlera e avanseve të pranuar në vitin 2008, e të shkarkuara në Janar 2009 në N.Q. "TERMOKOS" sh.a. është 207,599€;</p> <p>Vlera totale e zbritjeve të lejuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor është 741,671€.</p>	<p>Të dhënat e sistemit të faturimit për të gjitha zërat duhet të jenë të harmonizuara me zërat në sistemin e kontabilitetit, d.m.th librin kryesor, pasi që transaksionet analitike të konsumatorëve janë të regjistruara vetëm në modulën e sistemit të faturimit.</p> <p>Një funksion i rëndësishëm është harmonizimi (rakordimi) i librit ndihmës të llogarive të arkëtueshme me llogaritë kontrolluese të librit kryesor.</p> <p>Pa dashur që të injorojmë komentet tuaja, ne do të do të dëshironim që në auditimin e radhës të shohim një progres domethënës në këtë fushë, pasi që ky është procesi kyç në realizimin e të hyrave të Kompanisë.</p> <p>Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti duhet të forcojnë kontrollin lidhur me faturimet dhe inkasimet e të hyrave.</p>

	Vlera totale në	Periudha
Inkasimi (sipas Sistemit)	5,564,367 €	01-12/2009
Inkasimi (sipas Raporteve	5,616,113 €	01-12/2009
Diferenca	51,746 €	01-12/2009

Diferenca e përshkruar është si rezultat i avanseve të pranuar gjatë vitit 2009, të cilat kanë mbetur për tu shkarkuar në vitin 2010.

Me pastaj po i referohemi përshkrimit tuaj: "Regjistrimi i bilanceve individuale të klientëve është kryer në sistemin e faturimit nga njësi i Faturimit". Kjo thënie absolutisht nuk është e vërtetë dhe e kundërshtojmë në tërësi, pasi që Regjistrimi i bilanceve individuale të klientëve është kryer dhe vazhdon të kryhet nga Departamenti i Financave. Me saktësisht në Shërbimin e Faturimit bëhet ngarkimi i konsumatorëve me fatura, ndërsa Departamenti i Financave bënë shkarkimin e konsumatorëve për pagesat e tyre, punë kjo e cila realizohet nga Referenti për Shkarkimin e Pagesave. Kjo nënkupton se është e ndarë në tërësi ecuria e punës së regjistrimit të bilanceve individuale dhe nuk kryhen në shërbimin e njëjtë, por në departamente të ndryshme.

Sa i përket thënies tuaja se: " Nga tabela e mësipërme vërehet se nuk ekziston procesi final i barazimit për bilancet e gjeneruara nga sistemi i kontabilitetit me sistemin e faturimit", edhe kjo nuk mund të dëshmohet dhe nuk qëndron e vërteta e tillë sepse për shkak të programit në Sistemin e Faturimit shkarkesat e bëra kanë hyrë në total. Janë të përfshira të gjitha së bashku në total), ndërsa në Sistemin e Kontabilitetit shkarkesat janë të ndara veç e veç për arsye të trajtimit të" ndryshëm të këtyre shkarkimeve (paratë e pranuar, shuma e mjeteve të keqpërdorimeve, avanset si dhe kthimi nga zbritjet e lejuara). Pra, të katër këto nocione trajtohen veç e veç në

		<p>Sistemin e Kontabilitetit, në programin e Sistemit të Faturimit trajtohen/përfshihen në tërësi si përshkrim total).</p> <p>Në përshkrimin në vijim se: "Nga kërkimet tona ne kemi vërejtur se baza e të dhënave në sistemin e faturimit të kompanisë ka informacione jo të sakta lidhur me emrat dhe adresat e konsumatorëve aktual. Veç kësaj, ne jemi informuar se nuk ekzistojnë kontrole për të siguruar se të dhënat e vendosura në sistem janë të sakta dhe komplete". Po ashtu, edhe ky përshkrim nuk qëndron si i tillë dhe është jo real ngase prej 12.149 konsumatorë të N.Q. "TERMOKOS" Sh.a. përafërsisht vetëm 15 konsumatorë faturohen si N.N. dhe kjo mbetet deri në ditën e identifikimit të konsumatorëve. Për më tepër, gjeni të bashkëngjitur listën e konsumatorëve të cilët faturohen N.N.</p>	
3	Pika VI 3.1 Zbritjet e lejuara	<p>Raporti i auditimit mëtutje përmban: "Ne kemi vërejtur se nuk ekzistojnë politika dhe procedura të shkruara për t'u përdorur si udhëzues gjatë përgatitjes së pasqyrave të lejimeve që bëjnë të mundur ndarjen e periudhave kohore se kur konsumatori s'ka pasur ngrohje dhe kur duhet lejuar nga obligimet". Ky përshkrim është në kundërshtim me gjendjen reale, pasi që e vërteta qëndron kështu:</p> <p>-Zbritjet e lejuara deri më tani janë realizuar në bazë të dy vendimeve:</p> <p>*Vendimi i Bordit të Drejtorëve dt. 11/06/2008, nr. 733;</p> <p>*Vendimi i Bordit të Drejtorëve dt. 01/02/2010, nr. 155;</p> <p>Prove: Kopjet e vendimeve të lartshënuara.</p> <p>Përmes vendimeve kuptohet qartë se zbritjet e lejuara janë lejuar nga periudha 1999, pasi që nga ky vit ekzistojnë të dhënat lidhur me cilësinë e ngrohjes. Njëherit, zbritjet e lejuara janë realizuar në bazë të ankesave të pranuar nga ana e konsumatorëve gjatë viteve duke filluar nga viti 2009. Ekzekutimi i zbritjeve të lejuara është bërë në bazë të</p>	<p>Mungojnë procedurat e shkruara në lidhje me zbritjet e lejuara dhe futjen e të dhënave në sistem. Për më tepër ju thirrreni në Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Qershorit 2008. Ky vendim nuk mund të jetë i vlefshëm për disa vite, ngase vlerësimet mbi zbritjet duhet të bëhen çdo vit duke përcaktuar së pari kriteret e qarta se në çfarë bazash bëhen ato zbritje dhe cilat kategori konsumatorësh duhet të përfshihen në këtë grup.</p>

		<p>vendimeve të lartcekura.</p> <p>Sa i përket përshkrimit se: "Nuk ekzistojnë procedura të autorizimit për futjen e të dhënave në sistem", edhe kjo thënie nuk qëndron, ngase Udhëheqësi i Shërbimit të Faturimit është i autorizuar dhe në tërësi është përgjegjës për kryerjen e punës së Faturimit. Për këtë ju paraqesim argumentet siç janë:</p> <p>-Përshkrimi i vendit të punës sipas Kontratës mbi Marrëdhënie Pune të Udhëheqësit të Shërbimit për Faturim;</p> <p>-Kopje e raporteve mujore të fletëngarkesave të inkasantëve me fatura;</p>	
4.	VI.4 Shpenzimet e pagave	<p>ZRRE nuk përcakton numrin e personelit tonë, por shpenzimet e personelit janë një prej indikatorëve për caktimin e tarifave të shërbimeve tona.</p> <p>Numri i nevojshëm i punëtorëve varet nga nevojat e kompanisë, çështje kjo për të cilën vendosin organet e kompanisë duke u bazuar në aktet normative dhe ligjet në fuqi.</p> <p>Nuk është e saktë që ZRRE ka të drejtë të kufizoj numrin e të punësuarve apo të kufizoj pagat për të punësuarit.</p>	<p>Konkludimet tona janë të bazuara në nenin 15, pika "c" të Ligjit nr. 2004/9 si dhe në Raporti Rregullativ të lëshuar nga ZRRE-ja– Përcaktimi i të Ardhurave të lejuara për N.Q."Termokos" sh.a. Sezoni i Ngrohjes 2008/2009 , Tabela 1, fq. 9, ku ZRRE i ka lejuar N.Q. "Termokos"-it për shpenzime të personelit 755,300 € dhe numrin e personelit prej 170 të punësuarve.</p> <p>Komentet tuaja janë të pa bazuara për të ndryshuar gjetjet tona dhe si të tilla mbesin në raport.</p>
5	VI. 5 Shpenzimet e lëndës djegëse - mazutit;	<p>ANALIZA E KONSUMIT PER VITET FISKALE 2007,2008 DHE 2009</p> <p>Shifet se shpenzimi më i madh i mazutit ka qenë në vitin 2009. Kjo arsyetohet me këto të dhëna:</p> <p>Temperatura e jashtme mesatare në vitin 2009 (5.55°C) është më e ulët se në vitin 2008 (7.31°C), përkatësisht në vitin 2007 (5.69°C). Kjo ka kushtëzuar edhe numër më të madh të orëve të punës në këtë vit (5255 orë pune), përkatësisht shpenzim më të madh të mazutit.</p> <p>Në muajin prill të vitit 2008, në funksion të testimit të pajisjeve dhe sistemit, është punuar vetëm 24 orë, me ç'rast janë shpenzuar 45.8 ton mazut (nuk kemi punuar).</p>	<p>Gjatë analizave të treguesve ekonomik, intervistave dhe dëshmimeve të marra nga konsumatorët më të mëdhenj dhe të furnizuar rregullisht me ngrohje ne nuk kemi gjetur dëshmi se Kompania juaj ka ofruar ngrohje 24 orë siç pretendoni.</p> <p>Një diferencë kaq madhe në furnizimet gjatë vitit 2009 për 50% më e madhe në krahasim me vitin 2008, për mendimin tonë është mjaft indikative dhe është një flamur i kuq për Bordin e Drejtorëve se kësaj çështje duhet kushtuar vëmendje e posaçme. Këto paqartësi duhet të eliminohen dhe</p>

		<p>Gjithashtu, në muajin tetor të vitit 2008, për shkak të kushteve të mira atmosferike, nuk është punuar fare, ndërsa janë shpenzuar 25 ton mazut për testim të gatishmërisë së pajisjeve, me ngarkesa të ulëta në kohëzgjatje prej 34 orëve.</p> <p>Në janar të vitit 2009, sipas marrëveshjes, është punuar me regjim të pandërprerë (24 orë në ditë), prandaj detyrimisht është shpenzuar më shumë mazut (shiko tabelën Nr.1</p> <p>Kontrollimi i shpenzimit të mazutit dhe gjendja në rezervuar bëhet përmes leximit në shufrën e shkallëzuar, për secilin rezervuar. Kjo metodë, e cila përkundër faktit se nuk është e sofistikuar, është aplikuar vazhdimisht dhe jep rezultate të pranueshme. Gjendja e rezervuarëve nga leximi vizual, fletëpranimet e mazutit dhe raportet ditore të shpenzimit janë përcjell çdo ditë në departamentin e financave. Barazimi i pranimet dhe shpenzimit të mazutit gjithmonë ka qenë korrekt dhe i saktë.</p> <p>Në planin për investime kapitale është parapa instalimi i pajisjeve për matje elektronike, dhe lexim nga largësia, të nivelit përkatësisht sasisë së lëndës djegëse në të katër rezervuarët.</p> <p>Sa i përket shkyçjeve të cekura ato nuk ndikojnë në prodhim sepse për shkyçje blindohet vetëm pjesa sekondare, kurse pjesa primare funksionon . Energjia e prodhuar në kaldaja shkon gjer në këmbyes. Arsyeja pasi janë temperaturat e ulta mos të vie deri te ngrirja e sistemit.</p> <p>Sezona 2008 ka pasur problem me furnizim dhe para kohe është ndërprer Kontrata me furnizim, ku ka mbetur sasia ma e vogël e liferuar.</p> <p>Duhet shikuar se edhe rezervat sa kanë mbetur pas çdo sezoni.</p>	<p>sqarohen.</p> <p>Ne presim që Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i Kompanisë të merren me rekomandimet e dhëna, dhe në auditimin vijues, ne presim një progres domethënës në këtë kuptim.</p>
6.	VI.7 Kompensimi i drejtorëve të NP	<p>a. Konstatimet e juaja për këtë pikë nuk qëndrojnë ngase nuk janë në përputhje me gjendjen reale të fakteve. Nuk kanë bazë ligjore dhe gabimisht interpretojnë ligjin mbi NP.</p>	<p>Ne kemi analizuar me kujdes komentin tuaj, por ne vlerësojmë që komentet tuaja janë të pa baza dhe ne nuk do të ndryshojmë konkluzionet e</p>

		<p>b. caktimi i honorarit themelor për drejtorët e NP është bërë në pajtim me ligjin nr.03/L-087, duke u bazuar në nenin 20.2 të cilit nen i është referuar edhe draft-raporti.</p> <p>Me vendimin nr. 1539 dt. 01/07/2009, Komisioni i Aksionarëve në mbledhjen e përbashkët me BD dhe Komisionin e Auditimit ka caktuar kompensimin e drejtorëve të BD dhe pjesën shtesë për kryesuesin dhe Komisionin e auditimit.</p> <p>c. Në draft-raport ceket mungesa e një deklarate për politikën e kompensimit të BD por në mungesë të saj, BD nuk ka marrë kurrfarë kompensime të tjera.</p> <p>d. Nuk ka shumë kohë që BD ka filluar të punoj dhe është në proces të përgatitjes së politikës për kompensime.</p> <p>e. Konstatimi se kryesuesi dhe drejtorët e BD marrin një shtesë mujore, që është në kundërshtim me nenin 20.6 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, nuk është i saktë për këto arsye:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk e marrin shtesën drejtorët e BD, por kryesuesi dhe Komisioni i auditimit. - neni 20.6 i ligjit mbi NP është keqinterpretuar, ngase ai nen ka kuptimin si citojmë: Nuk mund të merren kompensime tjera të cilat nuk janë përcaktuar me instrumente juridike vendim, deklaratë mbi politikën e kompensimit apo kontratë pune. <p>f. Poashtu shkruhet për vendimin e BD për shtesën e Vitit të Ri nga 200€ për secilin punëtorë, gjë që e kanë marrë edhe anëtarët e BD.</p>	<p>auditimit për arsyet si vijon:</p> <p>c. BD ka marrë kompensim mujor në shumën prej 650 € dhe shtesë mujore 100 €;</p> <p>d. BD është emëruar me 28.05.2009, megjithatë nuk është ofruar asnjë dëshmi mbi politikën e kompensimit (deklaratë);</p> <p>* Konstatimi juaj nuk qëndron për faktin se edhe drejtori në BD merr shtesa.</p> <p>*Vendimi- nuk është instrument juridik, por është akt nënligjor dhe nxirret në përputhshmëri me ligjin, dhe nuk mund ketë fuqi mbi ligjin.</p> <p>f. Mungon një deklaratë për politikën e kompensimit.</p>
7.	<p>VI.8 Kompensimi i Drejtorëve Ekzekutiv të kompanisë</p>	<p>Teksti i pikës VI. 8 të draft-raportit janë shkruar gjëra që nuk ekzistojnë sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ekzistojnë “Drejtorët ekzekutiv në “Termokos” - nuk ekziston as bordi ekzekutiv në “Termokos” <p>Me kontratat e punës(marrëveshjet) nr.355, nr.354 dhe nr.1040 për tre zyrtarët, në pikën 9 të kontratave janë paraparë bonuset dhe lejimet shtesë financiare.</p>	<p>Kryeshefja ekzekutive./drejtor` në BD Drejtori i administratës /sekretar i BD dhe Drejtoresha financiare janë emërtuar si të tillë nga vet kompania. Kompania juaj posedon Listën e pagave të Bordit të drejtorëve dhe Lista e pagave të Bordit Ekzekutiv. Mungon dëshmia për bazën e pagesës së</p>

		<p>* Në fjalinë e dytë të pikës 8 shkruhet kinse nuk janë gjetur dëshmi të duhura mbi performancën e mirë të Bordit Ekzekutiv i cili nuk ekziston por sigurisht është menduar nga zyrtarët, rrethanë kjo që nuk qëndron fare ngase shkresa e BD e datës 25.04.2008 dhe procesverbalet e mbledhjeve të bordit të cilat ua kemi dorëzuar, ku janë bërë vlerësimet pozitive, e argumentojnë të kundërtën.</p> <p>* Shkrimi i ekipit të auditimit në pikën 8 është edhe në kontradikcion me vetvetën sepse në konkluzion në fjalinë e parë thotë: BD dhe Menaxhmenti me vendime të pa bazuara në Ligje e nuk e precizon se në cilat Ligje, por të bënë të kuptosh se mohon legjitimitetin e BD dhe Menaxhmentit për të marr vendime, ndërsa në pikën 1 të rekomandimit 8, thuhet se kompensimet duhet të jenë në pajtim me vendimet e BD dhe rregullat Ligjore.</p> <p>* Paga, bonuset dhe shtesat tjera eventuale përcaktohen si rregull, për secilin me: kontratë apo vendime dhe njëjtë është vepruar edhe me zyrtarët e kompanisë.</p> <p>* Sipas rregullit baza e kontratës mund të ndryshohet me vendime dhe kështu është vepruar sa i përket bazës se pagave e cila është ndryshuar me vendime përkatëse,.</p> <p>Fakt: - Shkresa e BD e datës 25.04.2008 lidhur me bonuset.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendimi i BD nr.787/1 i cili lejon ngritjen e pagave - Vendimet menaxheriale 1416 nr.267 të cilat bazohen në vendimin e BD - Vendimi nr.266 i DM - Vendimi i BD nr.1517 - Vendimet e DM nr. 1653 dhe nr.2206 të cilat bazohen në vendimin e BD nr.1539 të dt. 01.07.2009 - Të gjitha këto vendime janë në fuqi deri sa të shfuqizohen me ndonjë vendim tjetër. 	<p>bonuseve dhe shtesave për menaxhmentin e lartë. Dokumenti më nr.787/1,nuk është vendim por aprovim kërkesë(nr.787/1 e dt. 19/ 06/2008).</p> <p>Vend .nr. 1416 i datës 10/08/2008, që ju i referoheni, nuk është vendim i BD por i menaxhmentit tuaj.</p> <p>Vend. nr. 267 i dt. 02/02/2009, nuk ka bazë ligjore. Menaxhmenti nuk ka drejtë në ngritjen e pagës së Kryeshefit ekzekutiv.</p> <p>Bazuar në vendimin 1517 të dt. 30.06.2009 të BD, pika 4, shprehimisht theksohet paga bazë prej 2,780€, ndërsa për kompensime dhe stimulime duhet të bazohet në nenin 20.5 të ligjit mbi ndërmarrjet publike, gjë që nuk ka një politikë standarde të kompensimit.</p> <p>Gjetjet dhe konkluzionet e auditimit mbesin të pa ndryshuara dhe ne presim që të njëjtat t'i implementoni</p>
--	--	---	--

8	<p>VI.9.1 Furnizimi me mazut dhe derivate të naftës për ngrohje</p>	<p>Nga Auditori është cekur si gjetje shuma e paguar me tepër për Kontratën Furnizim me mazut në krahasim me kontratën, mirëpo si kriter ishte Premiumi më i ulët dhe në kontratë është cekur se Premiumi i kërkuar nuk ndryshon gjatë validitetit të kontratës por vetëm çmimi i tregut për derivate në baza ditore, ndërsa kalkulimi do të bëhet në baza 15 ditore që do të thotë çmim mesatar. Bazuar në dokumentacionin e prezantuar nga auditori dhe dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit, gjithçka është e argumentuar me shkresat dhe amendamentin e kontratës, bazuar në krizën globale që kaploi gjithë tregun botëror e posaçërisht tregun e derivateve në fillim të vitit 2009 përkatësisht gjatë sezonit të ngrohjes 2008/2009, me të cilat shkresa OE Compact Group nga Gjilani si bartës i GOE përkatësisht kontraktori për furnizim me mazut i është drejtuar, Autoritetit Kontraktues, Shoqatës së naftëtarëve të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Njesisë për Monitorimin e NP-ve duke kërkuar që kalkulimi të bëhet sipas Dokumentit Unik Doganor që ishte çmimi real i tregut nga të gjitha këto subjekte.</p> <p>Shoqata e naftëtarëve të Kosovës, Oda Ekonomike, dhe Njësia për Monitorimin e NP-ve në kuadër të MEF, ishte e mendimit se kriza aktuale i ka kapluar bizneset me derivate të naftës dhe mendimi i tyre ishte se mënyra më e pranueshme është përmes llogaritjes së çmimit sipas DUD-it. Prandaj bazuar në mendimin e NJPMNP në kuadër të MEF, Njësi kjo e cila monitoron NP-të, është amendamentuar neni përkatës i kontratës, dhe kalkulimi është bërë sipas DUD-vë, që është dokumenti me i pranuar dhe me valid për mallrat e importuara dhe i cili i përmban të gjitha elementet e nevojshme për kalkulim dhe ku pasqyrohet çmimi real i tregut në baza ditore.</p> <p>Këto fakte i janë ofruar dhe sqaruar edhe Auditorit dhe për të gjitha këto ekzistojnë dëshmi në dosje me të gjithë</p>	<p>Ligji mbi Prokurimin Publik obligon që të respektohet kontrata në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit ekonomik.</p> <p>Ligji mbi Prokurimin Publik për këtë rast, nuk njih asnjë shkresë të Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës apo MEF-it-Njesisë për Monitorimin e NP.</p> <p>Pagesat nuk është dashtë të bëhen jashtë kushteve të kontratës, pavarësisht pëlqimeve dhe shkresave nga shoqatat apo organet tjera. Në raste të tilla është dashtë të revidohet kontrata.</p> <p>Ne do të dëshironim që rekomandimet tona sa i takon kësaj çështjeje, të implementohen nga ana e menaxhmentit.</p>
---	--	---	---

		<p>dokumentacionin shoqërues, të cilat dokumentojnë se kjo gjetje e auditorit nuk pasqyron realitetin dhe se çmimi i paguar është as më shumë e as me pak se sa çmimi real i tregut për këtë artikull të liferuar për periudhat e caktuara kohore.</p> <p>Mënyra se si janë kalkuluar te Autoritetet tjera është çështje e autonomisë se tyre, mirëpo mënyra në Termokos është llogaritur bazuar në Amendamentin i cili është bërë në bazë të dokumenteve zyrtare nga Operatori Ekonomik , Oda Ekonomike, Shoqata e naftëtarëve, Njësia për Monitorim të NP-ve .</p> <p>Kontraktori ishte bartës i kontratës për Grupin Operator Ekonomik, Compact Group me Hib Petrol, dhe në raste të tilla OE të grupit e plotësojnë njeri tjetrin për çështje profesionale.</p> <p>Prandaj kërkohet nga Auditori që këtë gjetje ta korrigjoj duke u mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm të Autoritetit Kontraktues.</p>	
9	VI.9.2 Furnizim me gypa te paraizoluar dhe valvula	<p>Për kontratën Furnizim me gypa të para izoluar, si gjetje është paraqitur vonesat në liferim, gjë që nga raportet dëshmohej se malli PR Lot 2 është liferuar me kohë ndërsa për Lot 1 është liferuar në dy pjesë dhe arsyeja ishte se për gypa nuk kishte vend për deponimin e këtij malli pasi që hapësira në Termokos ishte e zënë me gypa të çeliktë dhe mbeturina përderisa është liru hapësira pjesërisht është shtyrë liferimi megjithëse nuk ka raport nga Projekt Menaxheri dhe komisioni për shtyerje të afatit, mirëpo nuk ka rekomandim për vonesat dhe ndërmarrje të penaltive.</p>	<p>Menaxhmenti i Termokos pranon se ka pasur vonesat në liferimin e materialit. Komenti sqaron se nën çfarë rrethana kanë ndodhur vonesat. Ne, megjithatë, mbesim në konkludimet tona se kontrata nuk është respektuar dhe ndëshkimet nuk janë aplikuar.</p>
10	VI.9.3 Furnizim me derivate të naftës për automjete	<p>Si gjetje nga Auditori është cekur se Kontrata për furnizim me derivate për automjete i është dhënë OE i cili nuk ka pasur çmimin më të ulët</p> <p>Mirëpo bazuar në dokumentacionin e disponueshëm dhe kriterin e kërkuar në Dosje: çmimi më i ulët që do të paguaj AK, faktet tregojnë se komisioni ka vlerësuar në</p>	<p>Gjatë auditimit dhe në komente nuk janë ofruar dëshmi të besueshme se janë respektuar kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit.</p> <p>Gjetjet tona dhe rekomandimet në raport mbesin të pa ndryshuara.</p>

		<p>favor të AK-së.</p> <p>Në Dosjen e tenderit është cekur se kontrata do t'i ipet OE me çmimin më të ulët duke marrë parasysh distancën shkuarje - ardhje nga AK deri te Pika e furnizimit me karburante (çka shihet në Listën e çmimeve).</p> <p>Në dokumentacionin vlerësues shihet qartë se si është përzgjedhur fituesi duke llogaritur:</p> <ul style="list-style-type: none"> -çmimin e ofertuar, - largësinë e pikës së karburantëve për furnizim dhe -kalkulimit të shpenzimeve për shkuarje ardhje deri te pika e karburanteve dhe tabelari sipas kriterit të kërkuar është në dosje dhe i është dhënë Auditorit në verifikim dhe padyshim se me këtë është paguar çmimi më i ulët i mundshëm <p>Si gjetje tjetër për këtë kontratë, Auditori ka deklaruar Komisionin e njejtë për Hapje dhe Vlerësim, çka deklarojmë se sipas LPP dhe Rregulloreve në fuqi AK nuk është i obliguar të formoj komision për hapje ndërsa është i obliguar formimin e komisionit vlerësues, mirëpo AK për shkak të transparencës mund të jetë e mundur që ka përdorur të njëjtin komision për hapje dhe vlerësim edhe pse siç e cekëm në bazë të LPP dhe Rregulloreve në fuqi për Hapje nuk është obligative formimi i komisionit fare dhe komisioni në fjalë kryesisht është konsideruar si komision vlerësues.</p> <p>Prandaj kërkojmë nga Auditori që këtë gjetje ta korrigjoj duke u mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm të Autoriteti Kontraktues.</p>	
11.	VI.9.4 Depërtimi i gypave nën asfalt	<p>Si gjetje e Auditorit te Kontrata për Puseta dhe Depërtim (jo vetëm për Depërtim) është kontratë në dy LLOTE ku është cekur se është tejkaluar vlera e kontratës.</p> <p>Nga kjo sqarojmë se për këto kontrata janë me çmime njësi dhe se fillimisht është zotuar një shumë e mjeteve, pasi që as në teren nuk ishte e mundur që të caktohet vëllimi i punës dhe se</p>	<p>Nuk është respektuar neni 2.1 i kontratës në mes të autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomi, që parasheh se çmimi total i kontratës duhet të jetë deri në shumën e mjeteve të zotuar.</p>

		<p>gjithçka diktohej nga punët në teren, prandaj shuma e zotuar fillimisht është korrigjuar me rishikimin e buxhetit në muajin Qershor-Korrik ashtu që të përmbyllët kjo kontratë me përfundimin e vitit fiskal.</p> <p>Shuma e zotuar: 43.000 € (për të dy Llotet)</p> <p>Shuma e rishikuar: 65,587 € (për të dy Llotet) që dmth se është me e madhe se sa vlera e shpenzuar.</p> <p>Prandaj kërkohet nga Auditori që këtë gjetje ta korrigjoj duke u mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm të Autoriteti Kontraktues.</p>	
12.	VI. 9.5 Shpenzimet e materialit të zyrës dhe mirëmbajtja e pajisjeve të ngrohjes	<p>Për shpenzimet e materialit për zyre, në pamundësi të zgjedhjes së ofertuesit për arsye të lojërave të mëdha me çmime nga Operatorët Ekonomik, nuk patëm mundësi ta zgjedhim ofertën më të lirë, prandaj furnizimet janë kryer me procedurë minimale të aplikueshme me ligj të prokurimit.</p> <p>Ndërsa pjesa për mirëmbajtje të pajisjeve të ngrohjes që figuron si gjetje, nuk është e qartë për arsye se nuk mund të gjejmë procedurë të iniciuar me këtë titull.</p> <p>Prandaj kërkohet nga Auditori që këtë gjetje ta korrigjoj duke u mbështetur në dokumentacionin e disponueshëm të Autoritetit Kontraktues</p>	<p>Komentet tuaja lidhur me këtë janë fare të pa qëndrueshme dhe ne presim që menaxhmenti të aplikoj procedurat e përcaktuara me LPP dhe jo të arsyetoj me të gjitha mjetet veprimet e kryera.</p> <p>Rekomandimet e dhëna në raport presim që të implementohen.</p>
13.	VI. 10 Menaxhimi i pasurisë	<p>Çështja e automjetit PEUGEOT 407 me targa (566-KS-971) është përfunduar në procedurë të rregullt dhe është bërë ndërrim me RENAULT CLIO dhe RENO TWINGO. Të bashkangjitur e gjeni :VENDIMIN PROCESVERBALIN DHE KONTRATA E SHITBLERJES.</p>	<p>Të gjitha transaksionet e shitblerjes duhet t'i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve duke aplikuar transparencën dhe mundësuar konkurrencën e tregut si mekanizëm rregullativ i përcaktimit të vlerave. Në rastin tuaj këto procedura nuk janë ndjekur.</p> <p>Konkluzionet e auditimit mbesin.</p>
14.	VI.11. Sistemi i kontrollit të brendshëm	<p>Pika VI.11 është në kundërshtim me gjendjen reale, pa përmbajtje dhe e pa saktë. Ne vazhdim po paraqesim argumentet:</p> <p>a.1 Në hyrje të pikës VI.11 të Draft-raportit në mënyrë të</p>	<p>Lëvizjet e punëtorëve kanë ndodhë në nivele të larta të menaxhmentit, siç është udhëheqësi i kontabilitetit, udhëheqës i prokurimit dhe punëtorëve tjerë, e jo punëtorët e programit social</p>

	<p>gabuar paraqitet numri i punëtorëve dhe lëvizja e tyre. Ne u kemi dhënë shënime të sakta me listën e punëtorëve të cilën e keni pranuar me 03.11.2009 dhe në te nuk figuron gjendja të cilën ju e paraqitni. Ju i konsideroni lëvizje të punëtorëve, punëtorët në program social dhe personat e angazhuar me kontratë mbi vepër, dhe këtë nuk keni të drejtë ta bëni, por ti përmbaheni listës të cilën ua kemi dorëzuar.</p> <p>* Në pikën VI.11 nën pika 1 e draft-raportit, keni shkruar për mos ndarje të detyrave të punës dhe është shumë e pasaktë ngase ne u kemi dorëzuar Strukturën organizative dhe kopjet e përshkrimeve të detyrave të punës dhe konsiderojmë se nuk ka nevojë për më tepër komente.</p> <p>* Në pikën VI.11 nën pika 2 e draft-raportit keni shkruar mungesën e Rregulloreve të brendshme në Kompani, dhe kjo nuk ka nevojë për koment.</p> <p>* Pika VI.11 nën pika 3 në të cilën shkruani lidhur me mosfunksionalizimin e organeve nuk është e saktë sepse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ne u kemi dorëzuar strukturën organizative dhe ju e keni nënshkruar pranimin e saj. - BD është funksional dhe ju keni kontaktuar me kryesuesin dhe i keni procesverbalet e BD. - Komisioni i auditimit funksionon dhe ju keni kontaktuar me kryetarin. - Komisionet profesionale formohen dhe veprojnë sipas nevojave të kompanisë. <p>* Pika VI.11 nën pika 5 e draft-raportit keni shkruar mbi lëvizjet e shpeshta të menaxhmentit dhe stafit . Ne kemi pas lëvizje të menaxhmentit në të cilët ju aludoni jo pse i kemi larguar por se vet kanë dhënë dorëheqje dhe këtë mund ta argumentojmë.</p>	<p>dhe punëtorët me kontratë mbi vepër.</p> <p>Mungon një rregullore e brendshme mbi regjistrimin dhe menaxhimin e mjeteve themelore (pasurive) të kompanisë.</p> <p>BD dhe Komisioni i Auditimit ekziston, por nuk ka dëshmi apo procesverbale se ka pasur aktivitete.</p> <p>Përkundër pretendimeve tuaja të shumta, ne mbesim prapa gjetjeve dhe rekomandimeve tona të auditimit dhe do të dëshironim që ato të implementohen në fazën vijuese.</p>
--	---	--

| Më tutje, Menaxhmenti i Termokos-it është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.